



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1313 prot.  
2

Tiranë, më 02.12.2022

**NJOFTIM PUBLIK**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi njofton z. Olsi Jazexhi, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa nr. 153, datë 03.10.2022, e znj. Zhaklin Lekatari dhe çështja ex-officio e nisur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Urdhërin Nr. 151, datë 30.09.2022, "Për ndjekjen kryesisht të çështjes së shprehjeve të përdorura nga shtetasi Olsi Jazexhi, kundrejt znj. Zhaklin Lekatari në emisionin "Ftesë në 5", të moderators Bieta Sulo, të datës 29.09.2022, të transmetuar në televizionin Top-Channel", ku pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë. Gjatë emisionit, në pjesën e dytë të tij, z. Olsi Jazexhi i është drejtuar znj. Zhaklin Lekatari (e ftuar në emision), duke përdorur shprehje diskriminuese dhe denigruese për shkak të gjinisë.

Ky njoftim kryhet në kushtet kur, Komisioneri nuk disponon asnjë adresë të z. Olsi Jazexhi, për të kryer korrespondencë zyrtare në kuadër të shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet shkresa nr. 1301/1, datë 03.10.2022, drejtuar z. Olsi Jazexhi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**



